

**VENDIM  
Nr. 39/2014**

**PËR MIRATIMIN E RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË KOMISIONIT HETIMOR TË KUVENDIT  
PËR HETIMIN E AKUZAVE MBI IMPLIKIMIN E FORCAVE TË ARMATOSURA DHE BAZAVE  
USHTARAKE NË VEPRIMTARI TË KUNDËRLIGJSHME - TRANSPORTIN E LËNDËVE  
NARKOTIKE, NGRITUR ME VENDIMIN E KUVENDIT NR. 26/2014, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe të nenit 22 të ligjit nr. 8891, datë 2.5.2002, “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”,

**KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

I. Miratimin e Raportit Përfundimtar të komisionit hetimor për hetimin e akuzave mbi implikimin e Forcave të Armatosura dhe bazave ushtarake në veprimtari të kundërligjshme - transportin e lëndëve narkotike, propozuar nga shumica e të gjithë anëtarëve të komisionit hetimor, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Miratuar në datën 12.6.2014

**KRYETARI**

Ilir Meta